Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional

MAPAS

BULETINI ELETKRONIK

# E-MAPAS

NR.54

## SHËRBIME DIGJITALE NË FINANCIMIN KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL

KORRIK VITI 2025

## KONTROLLI DIGJITAL I TË SIGURUARIT NË CILIN FOND TË DETYRUESHËM PENSIONAL ËSHTË ANËTAR

Në faqen e internetit të MAPAS gjendet një mjet i thjeshtë digjital për kontroll të shpejtë të çdo përdoruesi se në cilin fond të detyrueshëm digjital është anëtar. Ky mjet, përveç se i jep përdoruesit informacion se në cilin fond pensional është anëtar, e informon njëkohësisht edhe mbi mënyrën në të cilën mund ta ndjekë llogarinë e vet individuale.

Te ky mjet për kontroll të anëtarësimit arrihet nëpërmjet kësaj adrese në internet Kontrolli digjital - anëtarsimi.




## QASJE ELEKTRONIKE NË RAPORTIN E DETAJUAR PËR KURSIMIN PENSIONAL

Shoqëria pensionale siguron qasje elektronike në raportin e detajuar për kursimin pensional në llogarinë individuale të anëtarit në fondin e detyrueshëm pensional, përkatësisht në llogarinë vullnetare individuale dhe profesionale të anëtarit në fondin vullnetar pensional. Çdo anëtar i fondit pensional me emrin e vet të përdoruesit dhe me fjalëkalim mund të ketë qasje në llogarinë e vet në faqen e internetit të shoqërisë pensionale.

Te sistemi elektronik arrihet nëpërmjet këtyre adresave në internet të shoqërive pensionale:

SAVA - llogaria personale




KB Prvo - llogaria ime




TRIGLAV - llogarija personale




VFP - llogarija personale




## AZHURNIMI I TË DHËNAVE NËPËRMJET FAQES SË INTERNETIT

Shoqëria pensionale siguron azhurnim dhe korrigjim të të dhënave pensionale të anëtarëve të fond-eve pensionale nëpërmjet sistemit elektronik të vendosur në faqen e internetit. Të dhënat personale të cilat mund të azhurnohen janë:

- emri dhe mbiemri,
- adresa e banimit,
- vendi e banimit,
- kodi postal,
- vendi e korrespodencës,
- kodi postal për korrespodencë
- adresa e korrespodencës,
- telefoni dhe
- posta elektronike

Shoqëria pensionale siguron identifikim elektronik dhe kontroll të autorizuar të personit i cili do që të kryejë azhurnim të të dhënave.

## DORËZIMI I RAPORTIT PËR KURSIMIN PENSIONAL NËPËRMJET POSTËS ELEKTRONIKE

Shoqëria pensionale një herë në vit dorëzon Raport për kursimet pensionale në llogarinë individuale të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional, përkatësisht në llogarinë individuale dhe profesionale të anëtarit të fondit vullnetar pensional dhe Raportin për portofolin investues për çdo anëtar të fondit pensional në një zarf.

Ky njoftim, me pëlqimin paraprak të anëtarit, në vend që të dërgohet në zarf të gjelbër, mund të dorëzohet edhe në formë elektronike nëpërmjet postës elektronike.

## MAPAS – STAT

Të dhënat statistikore për financimin kapital të sigurimit pensionale janë në dispozicion të publikut edhe nëpërmjet mjetit të ri për të dhëna statistikore “MAPAS-STAT” i cili është vendosur në faqen e internetit të MAPAS-it. Ky mjet interaktiv bashkëkohor mundësohet nëpërmjet Business Intelegence Tool – Metabase.

“MAPAS-STAT” siguron qasje moderne dhe të thjeshtë në të dhëna, mundësi për filtrimin e pavarur të të dhënave, përgatitjen e serive kohore, vizualizimin interaktiv dhe shkarkimin e të dhënave. Gjithashtu me “MAPAS-STAT” sigurohet një vëllim i shtuar dhe frekuencë më e lartë e publikimit të të dhënave statistikore relevante për pjesëmarrësit, për të gjitha palët e interesuara dhe për publikun e gjerë.

"Me një klikim te pasqyra e të ardhmes tënde!"

"Llogaria yte me kursimin pensional, kontrolli yt - digjitalisht, gjithmonë dhe kudo!"

Te ky mjet për të dhënat statistikore arrihet nëpërmjet kësaj faqeje interneti: MAPAS-STAT Mjet për të dhëna statistikore.

- Вредност на сметководствена единица и нето средства
- Структура на инвестиции на пензиски фонд
- Вкупна структура на инвестиции на задолжителните пензиски фондови
- Вкупна структура на инвестиции на доброволните пензиски фондови
- Споредба на структура на инвестиции на задолжителните пензиски фондови
- Споредба на структура на инвестиции на доброволните пензиски фондови
- Членство во задолжителен пензиски фонд
- Членство во доброволен пензиски фонд
- Професионални пензиски шеми
- Придонеси во задолжителен пензиски фонд
- Придонеси во доброволен пензиски фонд
- Надоместоци во втор столб
- Надоместоци во втор столб - државни институции
- Принос на пензиски фондови - табела
- Принос на пензиски фондови - график
- Принос на пензиски фондови - номинален и реален - график

МАПАС-СТАТ

## REMZI BAJRAMI U ZGJODH KRYETAR I KËSHILLIT TË EKSPERTËVE TË MAPAS-IT

Në seancën e mbajtur, më 14 maj 2025, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut mori vendim me të cilin z. Remzi Bajrami u zgjodh kryetar i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.




## EDUKIM I SUKSESSHËM I STUDENTËVE TË FAKULTETIT EKONOMIK – SHKUP – UNIVERSITETI SHËN. KIRILI DHE METODIJ ME RASTIN E JAVËS GLOBALE TË PARASË

Më 15 prill 2023 në Fakulteti Ekonomik – Shkup ishte nikoqir i evenimentit edukativ me rastin e Javës Globale të Parasë me fokus në edukimin financiar dhe sistemin pensional.  Evenimenti u organizua nga Agjencia për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital – MAPASm shoqëritë pensionale KB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup, Sava Shoqëri pensionale SHA Shkup, TRIGLLAV Shoqëri pensionale SHA Shkup dhe VFP Shoqëri pensionale SHA Shkup në bashkëpunim me Kuvendin studentor të Fakultetit Ekonomik -Shkup.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.



## U MBAJT ME SUKSES DISKUTIMI NË PANEL ME RASTIN E JAVËS GLOBALE TË PARASË: "SI E FORMËSOJNË NJOHURITË FINANCIARE TË ARDHMEN TUAJ"

Shkup, më 14 prill 2025 2025 – Në suazat e Javës Globale të Parasë, në hapësirat e Netaville u mbajt diskutim në panel me temë "Si e formon njohje e financave të ardhmen tënde?", ku morën pjesë personalitete të shquara nga sektori financiar dhe akademik.




Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.

## JAVA GLOBALE E PARASË 2025-PRAKTIKA NJËDITORE EDUKATIVE PËR STUDENTË TË UNIVERSITETIT KOLEGJI AMERIKAN – SHKUP

Në suazat e bashkëpunimit të Agjencisë për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital (MAPAS) dhe Universitetit Kolegji Amerikan – Shkup, më 14.04.2025, nga pra 10.00-14.00 u mbajt praktikë njëditore edukative për studentë të Fakultetit të Ekonomisë Afariste dhe Biznesit.




Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.

**KENI PYETJE OSE ANKESA?**
**Paraqituni në MAPAS ose shkruani një mesazh në contact@mapas.mk**

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)
Slavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel: (02) 3224 229
www.mapas.mk

МКД СЕРТИФИКАТ
МКС EN ISO 9001:2009

TÜV NORD
TÜV NORD CERT GmbH
ISO/IEC 27001